

THE IMPACT OF THE 1968 DEMONSTRATIONS IN THE ADVANCEMENT OF THE ALBANIANS' RIGHTS IN KOSOVO

Haxhi Ademi

Institute of History "Ali Hadri"-Prishtina

Abstract

The paper treats the impact of the 1968 Demonstrations, which played an important role in later political advancements and the rights of Albanians in Kosovo. The demonstrations pushed the Yugoslav leadership to reconsider the legal status of Kosovo and on this occasion several concrete actions were taken. In February 1969, the constitutional law for Kosovo was adopted, which paved the way for Kosovo to have its own constitution. By law, the name "Kosovo and Metohija" as the province of Serbia, changed into the "Autonomous Socialist Province of Kosovo". On the same year the Albanian language was sanctioned by law as the second official language, in addition to the Serbian-Croatian language; afterwards the use of the national flag was legalized; while in November 1969, the Kosovo Assembly announced the law on the founding of the University of Kosovo, which would be implemented in February 1970.

The aim of this paper is to focus on the possible reflections of the 1968 demonstrations, which were also a cause for the advancement of Albanians' rights in the former Yugoslav Federation and as a result of this reflection the constitutional changes (1967-1971) followed, the Yugoslav Federal Assembly on February 21, 1974 adopted the new SFRY Constitution, and a week later (February 28) the Autonomous Socialist Province of Kosovo also adopts its first constitution, which defines Kosovo both as "an integral part of Serbia" and "constitutive element of the Yugoslav federation". However, this Constitution will never satisfy the will of the Albanian people, and therefore the illegal political organizations would not stop their patriotic activities for a single moment, in order to realize the goal and the major aspiration - self-determination and national unification.

Keywords: Demonstrations, 1968, Kosova, Yugoslavia, constitutional advancements, etc.

NDIKIMI I DEMONSTRATAVE TË VITIT 1968 NË AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË SHQIPTARËVE NË KOSOVË

Haxhi Ademi

Institute of History "Ali Hadri"-Prishtina

Abstrakt

Punimi trajton ndikimin e demonstratave të vitit 1968, të cilat patën një rol të rëndësishëm në avancimet e mëvonshme politike dhe të të drejtave të shqiptarëve në Kosovë.

Demonstratat detyruan udhëheqjen jugosllave të rishqyrtojë statusin juridik të Kosovës dhe me këtë rast u ndërmorën disa veprime konkrete. Në shkurt 1969 u miratua ligji kushtetues për Kosovën, i cili hapi rrugë që ajo ta ketë Kushtetutën e vet. Me anë të ligjeve emërtimi “Kosovë e Metohi” si krahinë e Serbisë, ndërron emrin në “Krahina Socialiste Autonome e Kosovës”. Po atë vit gjuha shqipe u sanksionua me ligj si gjuhë e dytë zyrtare, krahas gjuhës serbo-kroate; pastaj u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar; ndërsa në nëntor 1969, Kuvendi i Kosovës shpalli ligjin për themelimin e Universitetit të Kosovës, i cili do të jetësohet në shkurt të vitit 1970.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është përqendruar në reflektimet e mundshme të demonstratave të vitit 1968, të cilat edhe u bënë shkas për avancimin e të drejtave të shqiptarëve në ish- Federatën e Jugosllavisë dhe si rezultat i këtij reflektimi pasuan ndryshimet kushtetuese (1967-1971), Kuvendi federativ i Jugosllavisë më 21 shkurt 1974 miraton Kushtetutën e re të RSFJ-së, ndërsa një javë më vonë (28 shkurt) edhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e miraton Kushtetutën e parë të saj, e cila Kosovën e definon njëkohësisht, si: ”pjesë integrale të Serbisë” dhe ”element konstituiv të federatës jugosllave”. Megjithatë kjo Kushtetutë nuk do të kënaqë asnjëherë vullnetin e popullit shqiptar, prandaj dhe organizatat politike ilegale nuk do ta ndalin dot veprimtarinë e tyre atdhetare për asnjë moment, për të realizuar synimin dhe aspiratën madhore-vetëvendosjen dhe bashkimin kombëtar.

Fjalët kyçe: demonstratat, 1968, Kosova, Jugosllavia, avancimet kushtetuese etj.

POZITA KUSHTETUESE E KOSOVËS NË VITET 1945-1968

Kosova dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë janë pushtuar ushtarakisht nga Serbia në vitin 1912. Pushtimi u rikonfirmua përveç pas Luftës së Parë Botërore, me Paqen e Versajës (1919) edhe pas Luftës së Dytë Botërore, duke shkelur vullnetin e shprehur në konferencën e Bujanit (1943-44). Aneksimi i Kosovës dhe i hapësirave të tjera shqiptare nga ana e Jugosllavisë është përgatitur qysh gjatë përpjekjeve që u bënë për realizimin e marrëveshjes midis Këshillit Nacional Çlirimtar të Jugosllavisë (KNÇJ) dhe qeverisë mbretërore të Jugosllavisë në emigracion. Bisedimet e realizuara ndërmjet tyre u konkretizuan me “Marrëveshjen Tito-Shubashiq” (16 prill 1944) që u zhvilluan në bazë të vendimeve të Konferencës së Moskës, Teheranit dhe Jaltës, të cilat shprehën interesat e Fuqive të Mëdha për ndarjen e sferave të interesit në Ballkan, duke mos përjashtuar dhe Jugosllavinë.¹ Marrëveshja Tito-Shubashiq, duke mos përfillur fare vendimet e Konferencës së Bujanit,* pati për pasojë aneksimin e Kosovës nga Serbia, akt që u

¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*. (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1997), 301-313.

* Qëllim i organizimit të Konferencës së Bujanit (31 dhjetori 1943 – 2 janar 1944) ishte zgjerimi i Luftës Çlirimtare Antifashiste në Kosovë, duke e lidhur këtë me zgjedhjen e problemit kombëtar pas luftës, nga Konferenca e Bujanit doli me një dokument përfundimtar me rezolutë të miratuar në konferencë, ku thuhet: “Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashkue me Shqipërinë”, për më tepër shih: Mehmet Hoxha, “Formimi i Këshillit krahinor nacionalçlirimtar dhe rendisja e tije historike”, (Prishtinë: Përparimi, Nr.12, dhjetor 1959), 817-822; Ali Hadri “Formimi dhe roli i Këshillit Nacional – Çlirimtare për Kosovë- Metohi” (Prishtinë: Përparimin, Nr. 9, 10, 1963) 11-12; Ali Hadri, *Këshillat nacionalçlirimtar ne Kosovë*, Prishtinë, 1974; Ana Lalaj, “ Mbi Konferencën e Bujanit” në: E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptaret në Jugosllavi; “*Tubime*

zyrtarizua në Kuvendin e Prizrenit, (korrik 1945). Megjithëse ky kuvend nuk ishte as i pari dhe as i fundit, i cili solli vendime që Kosova të aneksohej nga Serbia e Jugosllavia. Aty kërkohej vetëm formalisht “*verdikti i popullit*”, ndërsa aneksimi i Kosovës kishte filluar qysh më herët.²

Plani përfundimtar për aneksimin e Kosovës është bërë pas vendosjes së administratës ushtarake në Kosovë, më 18 shkurt 1945, në mbledhjen që është mbajtur në Beograd.³ Po ashtu, Problemi i aneksimit të Kosovës në kuadër të Republikës së Serbisë është shtruar edhe në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë, që është mbajtur në Beograd nga 7-9 prill 1945. Në anën tjetër, kjo çështje nuk është diskutuar fare në Kosovë, ku qe vendosur Administrata Ushtarake.⁴ Dukë u mbështetur në këto vendimet që janë marrë në mbledhjet e sipërsënuara, pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova me Kushtetutën e parë të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, të miratuar më 31 janar 1946, u definua si njësi autonome territoriale-administrative brenda Serbisë e quajtur: “Qarku Autonom i Kosovës dhe Metohisë (QAKM)”. Bashkimi të dhunshëm i Kosovës me Serbinë ishte vetëm një pjesë e padrejtësisë që u bëhej shqiptarëve të ndarë nga Shqipëria londineze.⁵

Për më tepër në të gjitha dokumentet kushtetuese federative dhe republikane, nga viti 1946 deri në vitin 1963, statusi i gjuhës shqipe, ashtu si statusi i autonomisë së Kosovës, erdhi duke u rruhur dhe në këtë kontekst e gjithë jeta shoqërore e politike ekonomike e shqiptarëve ishte vënë nën kontroll të plotë të UDB-së, e cila kishte hapur rreth qindra mijë dosje për shqiptarët.

Mirëpo, me Kushtetutën e 7 prillit 1963, RFPJ shndërrohet në Republikë Socialiste Federative të Jugosllavisë (neni 1), ndërkaq Kosova shpallet Krahinë Autonome (neni 111), ndërsa shqiptarët nga nocioni “pakicë kombëtare”, me këtë Kushtetutë u definuan si “kombësi”. Megjithatë, kjo Kushtetutë nuk kishte sjellë ndonjë ndryshim esencial në trajtimin e shqiptarëve, por megjithatë sinjalizonte se është koha e ndryshimeve. Por këto ndryshime për shqiptarët ishin inekzistente ngase shqiptarët gjatë periudhës (1948-1966 që në popull quhej si koha e Rankoviqit), u përballën me një fushatë të egër shkombëtarizimi e shpërnguljeje masive nga Kosova, Sipas studiuesit Noel Malcom në harkun kohor 1945-1966 nga Jugosllavia u shpërngulen 246 mijë shqiptarë dhe se destinacion kishin Turqinë.⁶ Sipas historiografisë shqiptare numri i të shpërngulurve është edhe më i madh.⁷

shkencore për Konferencën e Bujanit, nga Komisioni për historianët e LKJ në KQ të LKJ, dhjetorë 1988” kronikë e gazetës Rilindja, 16 dhjetorë 1988; Danilo Erakovic, “*Kosova, tokë e premtuar*” cikël intervistash të Mita Milkovic dhën gazetës *Bora*, marrë nga gazeta Rilindja, në datë 19 deri 30 korrik 1989; Zekria Cana “mbledhja e Mukjës, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe Çështja e Bashkimit kombëtar” në *studime historike nr.1-4*, Tiranë 1992; *Konferenca e Bujanit*, (Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 1998); Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, (Tiranë: Toena, 2014), 185-241.

² Sabile Basha-Keçmezi, “*Shqipëria, pikë referimi për forcat nacionaliste në Kosovë, 1944-1945*”. Studime për Historinë Ushtarake, (Tiranë: Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014), 137.

³ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, 302.

⁴ Lefter Nasi, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës, (shtator 1944-1945)*. (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1994), 101.

⁵ Ana Lalaj, *Kosova-rruga e gjatë drejt vetëvendosjes (1948-1981)*. (Tiranë: 2000), 335.

⁶ Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër*, (Prishtinë: Koha, 2011), 407.

⁷ Zymer Neziri, “Demonstrat e viti 1968 dhe çështja e kombëtare shqiptare”, *Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I*. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës & Shoqata e të burgosurve Politikë të Kosovës, 2012), 27.

Qëndrimi që kishte Beogradi zyrtar ndaj shqiptarëve, nxiti reagimin e shqiptarëve, të cilët me të drejtë, por në mënyrë ilegale zhvilluan veprimtari kombëtare, për të parandaluar diskriminimin e vazhdueshëm dhe realizimin e idealit të shqiptarëve, shkëputjen nga Jugosllavia dhe bashkimin me shtetin shqiptar. Veprimtari të tillë zhvillonte Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, me në krye Adem Demaçin. Kështu, më 1964 UDB zbulon aktivitetin e kësaj lëvizjeje, andaj nëpër duar të UDB-së kaluan mbi 500 shqiptarë, 80 nga të cilët u nxorën para gjyqit.*

Pas rënies së vijës unitariste të përfaqësuar nga Rankoviçi, më 1966 dhe fitores së vijës titiste, për shqiptarët u krijua një gjendje më e lehtë. Historiografia shqiptare thotë se shqiptarët e shfrytëzuan krizën të cilën e përjetonte udhëheqja jugosllave, andaj ata kërkuan rishikimin dhe ndryshimin e statusit politik të Kosovës.⁸ Mirëpo, mos aprovimi i këtyre kërkesave ishte një nga shkaqet kryesore që nxiti organizimin e Demonstratave në vitin 1968.

ORGANIZIMI I DEMONSTRATAVE

Viti 1968 koicidon si vit jubilar në shënimin e ngjarjeve të mëdha të historisë sonë kombëtare, siç ishte 500-vjetori i vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, 90-vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 60-vjetori i Kongresit të Manastirit (Alfabetit Shqip më 14 nëntor 1908). Shënimi i këtyre ngjarjeve ka shërbyer për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar që diplomacia evropiane e ndërkombëtare të kuptonte se populli shqiptar po shtypej nga ana e Serbisë.⁹ Fillimisht ishte paraparë që demonstratat të organizoheshin më 10 qershor me rastin e 90 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por organizimi i tyre u pamundësua ngase u hetuan nga UDB-ja.¹⁰ Por, iniciativa për organizimin e tyre nuk u ndal deri në nëntor 1968, në muajin e festës së Flamurit Kombëtar dhe të Pavarësisë së Shqipërisë. Kështu, më 6 tetor filluan demonstratat e para në qytetin historik të Prizrenit, ku hapur është kërkuar Republika e Kosovës.¹¹ Kjo demonstratë ishte pra demonstrata e parë** masive në Kosovë edhe në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore,¹² e

*Gjykimi i dytë kundër themeluesit të LRBSH-së, Adem Demaçi, dhe 11 të akuzuarve të tjerë u mbajt më 27, 28, 29 e 31 gusht dhe 1 shtator 1964 në Gjyqin e Qarkut në Prishtinë. Në këtë gjykim, në “emër të popullit”, Demaçi – atëherë student i Fakultetit Juridik – u dënua me 15 vjet burg të rëndë. 50 vite më vonë, Demaçi vazhdon të jetë aktiv, sidomos me deklaratat për politikë. Me gjerësisht shih: Selatin Novosella, *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës*, Monografi 1. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politik, 2008), 67.

⁸Haxhi Ademi, “Pozita kushtetuese e Kosovës në periudhën 1966-1974”, *Revista Diskutime, Viti II- Nr.8*, (Qendra për marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime ballkanike dhe Instituti për studime Evropiane i Universitetit të Tiranës, 2013), 280-281.

⁹ Intervistë e realizuar me Meriman Brahon, më 6 tetor 2018 në Prizren, me rastin e 50 vjetorit të demonstratës.

¹⁰ Intervistë e realizuar me Zmer Nezirin, më 6 tetor 2018 në Prizren, me rastin e 50 vjetorit të demonstratës.

¹¹Selatin Novosella, *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës, Monografi 1*, 97.

** Këshilli organizativ i kësaj demonstratë ishte i përbërë nga student, nxënës, të Normales dhe të Gjinnazit, intelektualëve e zanatlinjve si: Merman Braho, Haxhi Maloku, Pashk Laçi të Prizrenit, Isa Demaj - Rugovë, Gjergj Camaj -Tuzi, Rafet Rama- Rahovec, Zymer Neziri- Pejë, Shpresa Elshani, Simon Kuzhini, Lemane Braha, Shqipe Vokshi, Haxhi Bajraktari, Selajdin Braha, Pjetër Drehsja, Isa Morina. Shih veprën: Selatin Novosella, *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës, Monografi 1*, 99-100.

¹²Selatin Novosella, *Demonstratat e Gjashtëdhjetetës*, 99; Meriman Braha, *Demonstratat e Prizrenit më 6 tetor 1968*, në *Demonstratat e vitit 1968*, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 39-54; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, 441-442.

cila më pas shërbeu si motiv për fillimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të organizimit të demonstratave në qytetet e tjera të Kosovës dhe jo vetëm, ngase demonstratat me kërkesa të njëjta u zhvilluan edhe në trevat e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi si demonstrata në qytetin e Tetovës (Maqedoni), më 22-23 dhjetor 1968 dhe demonstrata në qytetin e Ulqinit (Mal të Zi).

Dy ditë pas demonstratës së Prizrenit, pra më 8 tetor 1968 u organizuan një demonstratë edhe në Suharekë (tani Therandë). Kërkesat në këtë demonstratë ishin “Kushtetutë-Republikë”, “Duam Universitet” dhe “Rrnoft Flamuri”. Numri i demonstruesve ishte tejet i madh, sa që policia u zu në befasi nga ky numër i madh.¹³ Kërkesat thuajse të njëjta që kryesisht kanë të bëjnë me avancimin e statusit të Kosovës në nivel të Republikës u bënë edhe në Pejë, më 19 tetor 1968, ku u organizua demonstrata me kërkesat: “Rroftë flamuri kuq e zi”, “Rroftë populli shqiptar!” “Rroftë Kushtetuta”, etj.¹⁴ Edhe pse demonstratat e realizuara në tri komunat e lartcekura ndikuan në ndërgjegjësimin e popullsisë shqiptare, ngase pas këtyre demonstratave numri i atyre që morën pjesë në demonstratat e organizuara më 27 nëntor, ishte shumë më i madh. Megjithëse, demonstrata e Prizren, Therandë dhe në Pejë, nga historiografia shqiptare¹⁵ dhe ajo e huaj,¹⁶ nuk iu kushtua një vëmendje e merituar. Ndonëse, këto demonstrata u ndoqën më pas nga demonstratat të tjera në qytetet kryesore të vendit si Prishtinë, Ferizaj, Gjilan dhe Podujevë, si dhe në qytetin e Tetovës dhe të Ulqinit. Gjithë demonstratat e organizuara në qytetet e sipërshënuara ku u shprehën hapur kërkesat e popullit shqiptar tronditën themelet e shtetit komunist jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore. Si të tilla, ato patën jehonë në popull dhe rikthyen një kohë që pothuajse “ishite harruar”. Shqiptarët kërkonin më shumë të drejta dhe shpallën vendosmërinë e tyre për të luftuar për të drejta kombëtare dhe njerëzore, duke u ngritur kundër autoritetit të shtetit jugosllav që për dekada i kishte shtypur, i kishte ndrydhur dhe vazhdonte të mos i dëgjonte.

Andaj, në demonstratat e nëntorit të vitit 1968, rinia shqiptare në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, u ngrit kundër autoriteteve të shtetit duke kërkuar më shumë të drejta kombëtare dhe njerëzore që në esencë siç u kërkuar edhe në demonstratat, synohej të arrihej statusi i Republikës së Kosovës.¹⁷ Kështu, më 27 nëntor 1968 u organizuan demonstrata në

* Më 8 tetor 1968, ishte ditë tregu dhe pjesëmarrja parashihej që të ishte sa ma masive. Haxhi Bajraktari (mësues në shkollën e fillore të fshatit Nishor) ishte bartësi kryesor i organizimit të kësaj proteste.

¹³Selatin Novosella, *Demonstrata e Gjashtëdhjetetës, Monografi 1*, vep.cit., 102-107; Haxhi Bajraktari, *Si u organizua demonstrata e 8 tetorit 1968 në Therandë*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 55-60; Izet Baraliu, *Rrethanat që iu paraprinë demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968*, vepër e cituar., 295-308; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, 442-444.

¹⁴Selatin Novosella, *Demonstrata e Gjashtëdhjetetës, Monografi*, 107-113; Zymer Neziri, Isa Demaj – jeta dhe veprimtaria atdhetare, (Shoqata e të Burgosurve Politik Shqiptarë, Prishtinë, 200), 179. Sabile Kicmezi-Basha, *Kosova 1945-1990, (Vështrim historiko-politike)*, (Instituti i Historisë- Prishtinë, Prishtinë, 2017), 151. Demë Mulliqi, *Rrjedha e demonstratave të '68-ës në Pejë*, Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012), 61-70; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, vepër e cituar., 444- 445.

¹⁵*Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi IV. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (Tiranë: Toena, 2008), 362; Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Botim i ri, Vëllimi i parë: A –GJ, (Tiranë: Akademi e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, 2009), 446.

¹⁶ Sipas Noel Malcom “Për të parën herë parulla Kosova Republikë u dëgjua në rrugë më 27 nëntor 1968”. Më gjerësisht shih: Noel Malcom, 410.

¹⁷ Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*. Botimi i dytë, (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2017), 218.

këto komuna: Gjilan,* Besianë**, Ferizaj (për organizimin e protestës në këtë komunë është paraqitur në këtë simpozium me kumtesën tij studiuesi Skender Lutfiu), Prishtinë, dhe sipas Selatin Novoselles demonstrata u organizuan edhe në Mitrovicë¹⁸ megjithëse, në historiografinë shkencore shqiptare nuk hasim në të dhëna që dëshmojnë organizime të tilla që kishin ndodhur në këtë komunë. Demonstrata nuk u organizuan vetëm në territorin e Kosovës së sotshme administrative, por ato siç e kemi cekur më lartë janë organizuar edhe në Tetovë*** dhe në Ulqin.

Demonstrata e organizuar në Prishtinë pa dyshim ishte ndër demonstratat më të mëdha në Kosovë. Për organizimin e tyre masat e rinisë studentore dhe masat e gjera popullore ishin njoftuar për kohën dhe vendin e fillimit të demonstratave, që në orët e para të pasdites. Për kundër forcave të mëdha policore të përqendruara nëpër udhëkryqet kryesore të Prishtinës, qytetarët ishin tubuar nëpër fushat sportive të qytetit, nëpër konviktet e studentëve, nëpër shkolla fillore dhe të mesme si dhe nëpër vende tjera publike, duke pritur çastin e fillimit të demonstratës.¹⁹ Demonstrata nisi rreth orës 16, para Fakultetit Filozofik të Prishtinës.²⁰ Deri në orën 17 masa e demonstruesve u rrit në rreth 8 mijë veta.* Demonstruesit, mbanin në duar pankarta transparente me parulla të shkruara si: “Duam vetëvendosje deri në

*Në Gjilan demonstratat filluan në ora 12 e 5 minuta, duke u nisur nga shkolla e Mesme ekonomike për të vazhduar më pasë në drejtimin e stacionit të autobusëve. Në demonstratat e Gjilanit morën pjesë mbi 2000 veta, ku demonstruesit përveç Gjilanit vinin edhe nga Kamenica, Kaçaniku, Vitia, nga Kosova lindore Presheva, Bujanoci e qytete tjera shqiptare. Në demonstratë valëvitej edhe flamuri kombëtar shqiptar. Demonstrata në Gjilan. Për organizimin e kësaj demonstrate nga organet shtetërore u gjykuan: Irfan Shaqiri-një vit burg, ndërsa Rexhep Mala, Xhavit Dërmaku, Ahmet Hoti dhe Fatmir Salihu me dënime nga Gjykata për Kundërvajtje. Më gjerësisht shih: Selatin Novosella, *Demonstrata e Gjashtëdhjetetës, Monografi 1*, 113-119.

**Demonstrata në Besian (Podujevë) u zhvilluan në orën 13:00 të datës 27 nëntor, kjo ngase demonstruesit e kësaj komune dëshiron të merrnin pjesë në demonstratën e Prishtinës. Masa e demonstruesve fillimisht u mblodhe në sheshin e qytetit. Në ballë të demonstruesve valonte flamuri kombëtar, (i qëndisur nga Elhame Shala-Bogujevci). Demonstruesit në këtë komunë sikur se edhe në komunat tjera kërkuan: vetëvendosje, kushtetutë po ashtu kërkuan barazi kombëtare në kuadër të Jugosllavisë “LNÇ nuk solli barazi të plotë”. Para demonstruesve foli: Sabit Sylja - student nga fshati Obraqë i Podujevës. Meqenëse demonstruesit nuk u provokuan nga policia, demonstrata përfundojë e qet. Më pas një numër shumë i madh i demonstruesve ju bashkua demonstratës në Prishtinë. Për organizimin e kësaj demonstrate u gjykuan Hamit Abdullahi (berber) një vite e katër muaj burg; Sabit Sylja (student) një vit e dy muaj burg, dhe Hakif Sheholli (mësues) me një vite burg. Po ashtu, u dënuan me nga 30 ditë burg edhe këta demonstrues: Hasan Shala (mësues nga Letonica dhe vëlla i dëshmorit Shaban Shala, i mbytur me torturat në Burgun e Prishtinës në vitin 1963), Shaqir Shala (mësues), Bahri Shabani (mësues), Xhafer Ejupi (mësues), Nexhmie Ejupi (rrobaqepëse), Abdullah Nishevci (rrobaqepës), dhe Nezir Bunjaku (berber). Me gjerësisht shih Abdullah Nishevci, “Bujku”, 27.11.1996.

¹⁸Selatin Novosella, *Demonstrata e Gjashtëdhjetetës, Monografi 1*, 13.

¹⁹Demonstratat në Maqedoni konkretisht në Tetovë u mbajtën më 22-23 dhjetor. Demonstruesit kërkuan që shqiptarët në Maqedoni të bashkëngjiten “Republikës së Kosovës” duke krijuar një njësi të vetme administrative me të gjitha të drejta të barabarta me kombësitë tjera. Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Botim i ri, Vëllimi i parë: A –GJ, 446; Faik Mustafa, “*Demonstratat e 68-ës – Lëvizje e shqiptarëve në Maqedoni*”, Demonstratat e vitit 1968, vepër e përmendur., 97- 102; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, vepër e përmendur. 457-465.

²⁰Zëri i Kosovës, *Demonstratat popullore të vitit 1968 në Kosovë dhe viset e saja*. Nr.11/12, nëntor-dhjetor 1988, Zvicër, 8.

²⁰“Çka ndodhi në Prishtinë”. Rilindja. Prishtinë, 30 nëntor 1968, 7.

* Për sa i përket numrit të pjesëmarrësve në këtë demonstratë historiografia shqiptare na ofron të dhëna të ndryshme. Në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar I, të botuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë thuhet “Rreth 500 demonstrues, kryesisht student e nxënës të shkollave të mesme, dolën në rrugët kryesore të Prishtinës” 446.

shkëputje”, “Poshtë politika kolonialiste ndaj Kosovës”, “Duam bashkimin e të gjitha viseve shqiptare me Kosovën”, “LNÇ-ja nuk na solli lirinë!”, “Duam Kushtetutë!”, “Duam Universitet!”, Para qendrës së studentëve, tani Rektorati i Universitetit të Prishtinës, demonstruesit u përballën me kordonin e policisë dhe gjatë përleshjeve masa e demonstruesve e shpërtheu bllokimin. Demonstruesit kërkonin t’ju fliste Fadil Hoxha, në të kundërtën do të hynin me dhunë në objektin e Kuvendit. Të pakënaqur me përfaqësuesit shqiptarë në nivelet e larta shtetërore, demonstruesit filluan të brohorasin parulla kundër burokracisë politike si: “Poshtë burokracia!”, “Poshtë tradhtarët!”, “Poshtë Veli Deva!”, “Rroftë Klasa punëtore!”, “Rrofshin minatorët”, “Rroftë rinia”, “Poshtë Fadil Hoxha”, “Rroftë vëllazëria shqiptare”, etj. Në anën tjetër kishte personalitete shqiptare që demonstruesit brohorisnin emrin e tyre në kuptimin e mbështetjes si: “Rroftë Adem Demaçi”, “Rroftë Kadri Halimi”, pastaj “Duam lirinë e të burgosurve politikë” etj. Strukturat e burokracisë politike për t’i bindur demonstruesit se duhej të shpërndaheshin, me qëllim të qetësimit të situatës, kishin caktuar Ismail Bajrën për të biseduar me ta.

Ai për t’i shqyrtuar kërkesat e shtruara përmes bisedimeve, kërkoi nga demonstruesit që të formonin një kryesi të tyre, mirëpo masa e tubuar njëzëri ju përgjigje se “Të gjithë jemi kryesi! të gjithë jemi kryesi!” Kur pushoi së foluri z. Bajra, filloi të buças zëri i demonstruesve për lirinë e shokëve të burgosur, gjatë këtij demonstrimi. Me brohoritjet ”Lironi shokët, lironi shokët*”, Forcat policore për ta shpërndarë masën e tubuar përdori gazin lotsjellës, shkopinj gome dhe armë zjarri.

Në ndihmë të policisë me këtë rast kishin ardhur edhe ushtria. Gjatë kësaj përleshjeje nga breshëritë e plumbave që vinin nga banesat e ballkoneve shtetërore, që gjendeshin mbi hotelin ”Avalla”, vritet i riu 17 vjeçar Murat Mehmeti, nxënës i shkollës së mesme teknike në Prishtinë dhe u plagosën shumë të tjerë.²¹ Për të qetësuar studentët, me kërkesën e strukturave para masës paraqitet edhe prof. Mark Krasniqi, i cili u bëri thirrje demonstruesve që të shpërndahen, por masa nuk e përfilli kërkesën e tij. Duke brohoritur parulla tani më të njohura dhe duke kënduar këngë të ndryshme patriotike, një pjesë e demonstruesve qëndruan në platonë e Fakulteti Filozofik, deri në orën 3 të mëngjesit, të datës 28 nëntor 1968.

Por çfarë ndikimi patën këto demonstrata dhe sa ndikuan në përmirësimin e jetës shoqërore dhe sa avancuan shqiptarët në të drejtat e tyre politike?

Së pari, këto demonstrata tronditën themelet e shtetit komunist jugosllav,²² sepse për herë të parë në mënyrë të organizuar në Kosovë dhe jo vetëm filloj të brohoriste zëri i arsyes qytetare.

Së dyti, demonstrata luajti një rol të rëndësishëm në avancimet politike dhe të të drejtave të shqiptarëve në Kosovë.²³ Së treti, këto demonstrata kishin rëndësi të madhe, sepse ishin

*Masat demonstruese e nisën marshimin në drejtim të burgut famëkeq të Prishtinës. Nga udhëkryqi, përballë shtëpisë së vjetër të mallrave, masa mori rrugën në drejtim të shtëpisë së armatës (APJ) dhe u grumbulluan para hotelit “Avalla”, në afërsi të burgut.

²¹Selatin Novosella, *Demonstrata e Gjashtëdhjetetës*, Monografi 1, (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politik, 2008), 177.

²² Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*, 218.

²³ Sheradin Berisha, “Roli historik i Demonstratave shqiptare të vitit 1968”, *Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës& Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012), 435-465.

prioritare për ndërgjegjësimin e popullit shqiptar që diplomacia evropiane e ndërkombëtare të kuptonte se ky popull po shtypej nga Serbia.²⁴

Si përfundim mund të themi se këto demonstrata, detyruan udhëheqjen jugosllave, të rishqyrtojë statusin juridik të Kosovës dhe me këtë rast u ndërmorën disa veprime konkrete. Kështu, në shkurt të vitit 1969 u miratua ligji kushtetues për Kosovën, i cili i hapi rrugë që edhe ajo ta ketë Kushtetutën e vet. Po atë vit gjuha shqipe u sanksionua me ligj si gjuhë e dytë zyrtare,** krahas gjuhës serbo-kroate; pastaj u legalizua përdorimi i flamurit kombëtar; ndërsa në nëntor 1969, Kuvendi i Kosovës shpalli ligjin për themelimin e Universitetit të Kosovës, i cili do të jetësohet në shkurt të vitit 1970.²⁵ Ndikimi i këtyre demonstratave ishte tejet i madh edhe për faktin se pas debateve maratonike për ndryshimet kushtetuese (1967-1971), Kuvendi federativ i Jugosllavisë më 21 shkurt 1974 miraton Kushtetutën e re të RSFJ-së, ndërsa një javë më vonë (28 shkurt) edhe Krahina Socialiste Autonome e Kosovës e miraton Kushtetutën e parë të saj, e cila Kosovën e definoi njëkohësisht, si: "pjesë integrale të Serbisë" dhe "element konstituiv të federatës jugosllave". Me gjithë ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, shqiptarët emëroheshin si kombësi dhe jo si komb, edhe pse ishin populli i tretë pas serbëve dhe kroatëve.²⁶ Pra kjo Kushtetutë nuk përmbushte vullnetin dhe nevojën e popullit shqiptar, andaj dhe organizatat politike ilegale nuk do ta ndalin dot veprimtarinë e tyre atdhetare për asnjë moment, për të realizuar synimin dhe aspiratën madhore-vetëvendosjen dhe bashkimin kombëtar me shtetin amë Shqipërinë.

Literatura

Albin Kurti, *Kërkesat për vetëvendosje në vitin 1968 dhe sot*, Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës&Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012).

Ali Hadri "Formimi dhe roli i Këshillit Nacional – Çlirimtare për Kosovë- Metohi" (Prishtinë: Përparimin, Nr. 9, 10, 1963).

Ali Hadri, *Këshillat nacionalçlirimtar ne Kosovë*, (Prishtinë: Enti i Historisë së Kosovës, 1974).

Ana Lalaj, " Mbi Konferencën e Bujanit" në: E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi; "*Tubime shkencore për Konferencën e Bujanit*, nga Komisioni për historianët e LKJ në KQ të LKJ, dhjetorë 1988" kronikë e gazetës Rilindja, 16 dhjetorë 1988.

Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, (Tiranë: Toena, 2014).

Ana Lalaj, *Kosova-rruga e gjatë drejt vetëvendosjes (1948-1981)*. (Tiranë: 2000).

²⁴*Historia e Popullit Shqiptar*, 364.

^{**}Demonstratat e vitit 1968 kishin rëndësi të madhe për popullin shqiptar, sepse ishin prioritetet. Pas demonstratave të vitit 1968 në Universitetin e Kosovës filloi të rritet numri i studentëve shqiptarë. U hapën shumë shkolla fillore dhe të mesme në të gjitha komunat e Kosovës, që ndikoi në emancipimin e femrës shqiptare. Krahas rritjes së numrit të nxënësve dhe studentëve shqiptarë, u rrit edhe numri i librave në bibliotekat e Kosovës, që dikur në fondin e tyre kishin 75 për qind libra në gjuhën serbokroate, dhe 25 për qind në gjuhën shqipe, kundrejt popullit shumicë shqiptar me 90 për qind. Jo vetëm kaq, sepse pjesa më e madhe e librave të përkthyer ishin nga shkrytarët jugosllavë, mbi mesataren e letërsisë kombëtare shqiptare. Para demonstratave të vitit 1968, shkollat e larta dhe fakultetet në Prishtinë më shumë kishin studentë serbë të ardhur nga Serbia Jugore se shqiptarë nga Kosova. Më gjerësisht shih: Sheradin Berisha, "Roli historik i Demonstratave shqiptare të vitit 1968", *Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I*, 435-465.

²⁵ Bashkim Lajçi, Përpykjet dhe pengesat në zhvillimin e etimologjisë në Kosovë pas vitit 1968, *Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës& Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012), 186

²⁶ Albin Kurti, "Kërkesat për vetëvendosje në vitin 1968 dhe sot". *Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës& Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012), 135.

Demë Mulliqi, *Rrjedha e demonstratave të '68-ës në Pejë*, Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012).

Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Botim i ri, Vëllimi i parë: A –GJ, (Tiranë: Akademi e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, 2009).

Haxhi Ademi, “Pozita kushtetuese e Kosovës në periudhën 1966-1974”. *Revista Diskutime, Viti II- Nr.8*, (Qendra për marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime ballkanike dhe Instituti për studime Evropiane i Universitetit të Tiranës, 2013).

Haxhi Bajraktari, *Si u organizua demonstrata e 8 tetorit 1968 në Therandë*, Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012).

Historia e Popullit Shqiptar, Vëllimi IV. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. (Tiranë: Toena, 2008)

Izet Baraliu, *Rrethanat që iu paraprinë demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968*, 295-308; Sheradin Berisha, *Roli historik i demonstratave shqiptare të vitit 1968*, Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012).

Konferenca e Bujanit, (Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 1998).

Lefter Nasi, *Ripushtimi jugosllav i Kosovës*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1994)

Mehmet Hoxha, “Formimi i Këshillit krahinor nacionalçlirimtar dhe rendisja e tije historike”, (Prishtinë: Përparimi, Nr.12, dhjetor 1959).

Meriman Braha, *Demonstrata e Prizrenit më 6 tetor 1968*, në Demonstratat e vitit 1968, vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, 2012).

Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*. (Prishtinë: Instituti i Historisë, 1997).

Noel Malcom, *Kosova një histori e shkurtër*. (Koha, Prishtinë, 2011).

Sabile Basha-Keçmezi, *Shqipëria, pikë referimi për forcat nacionaliste në Kosovë, 1944-1945*. Studime për Historinë Ushtarake. (Tiranë: Instituti i Studimeve të Historisë Ushtarake, 2014).

Sabile Kicmezi- Basha, *Kosova 1945-1990*, (Vështrim historiko-politike), (Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 2017).

Sabit Syla, *Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës 1939-1981*. Botimi i dytë. (Prishtinë: Instituti i Historisë- Prishtinë, 2017)

Selatin Novosella, *Demonstratat e gjashtëdhjetetës 1 (Monografi), 2 (dokumente) dhe 3 (Portrete)*. (Prishtinë: Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2008).

Sheradin Berisha, *Roli historik i Demonstratave shqiptare të vitit 1968*. Demonstrata e vitit 1968, Vëllimi I, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës & Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës, 2012).

Zekria Cana “Mbledhja e Mukjës, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe Çështja e Bashkimit kombëtar” (Tiranë: Studime Historike, nr.1-4, Tiranë 1992).

Zymer Neziri, “*Demonstratat e vitit 1968 dhe çështja e kombëtare shqiptare*”, Demonstratat e vitit 1968, Vëllimi I. (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës & Shoqata e të burgosurve Politikë të Kosovës, 2012).

Zymer Neziri, Isa Demaj – jeta dhe veprimtaria atdhetare, (Shoqata e të Burgosurve Politik Shqiptarë, Prishtinë, 200), 179. Sabile Kicmezi- Basha, *Kosova 1945-1990*, (Vështrim historiko-politike), (Instituti i Historisë- Prishtinë, Prishtinë, 2017).

Intervistat:

Intervistë e realizuar me Meriman Brahon, më 6 tetor 2018 në Prizren.

Intervistë e realizuar me Zymer Nezirin, më 6 tetor 2018 në Prizren.

Shtypi:

Zëri i Kosovës, Zvicër, nëntor-dhjetor 1988.

“Rilindja, Prishtinë. 30 nëntor 1968.